



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Community
Investment Platform
Платформа за
инвестиции во заедницата
Platforma për
investime në komunitet



THIRRJE PËR NDARJEN E GRANTEVE PËR ORGANIZATA QYTETARE – FAZA E PARË 2022

PLATFORMA PËR INVESTIME NË KOMUNITET

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 22.04.2022, ora 16:00.

Data e publikimit të thirrjes: 22.03.2022

Numër referimi i projektit: IPA/2020/421-147

Periudha e zbatimit të projektit: 01.01.2021 – 30.04.2024



PËRMBAJTJE

1. RRETH PROJEKTIT	3
2. RRETH THIRRJES.....	4
3. E DREJTA PËR APLIKIM.....	4
3.1 AKTIVITETE TË PËRSHTATSHME	5
4. MJETET E DISPONUESHME DHE SHPENZIMET	5
4.1 MJETET E DISPONUESHME	5
4.2 SHPENZIMET TË CILAT I MBULON PROJEKTI.....	5
4.3 SHPENZIMET TË CILAT NUK I MBULON PROJEKTI	6
5. MËNYRA E APLIKIMIT.....	6
5.1 LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM TË PLOTË:	6
5.2 PROCEDURA DHE AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM	6
6. VLERËSIMI I PROPOZIM-PROJEKTEVE.....	8
6.1 VERIFIKIMI I APLIKIMEVE	8
6.2 VLERËSIM PËR CILËSINË DHE PËRSHTATSHMËRINË E APLIKIMIT	8
7. INFORMACIONE SHITESË	9

1. RRETH PROJEKTIT

Projekti “Platforma për investime në komunitet” (CIP) është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Fondacioni Albiz nga Shkupi, në partneritet me Shoqatën Multikultura nga Tetova, Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit nga Dibra dhe Qendrën për hulumtime dhe analiza NOVUS nga Strumica.

Objektivi kryesor i projektit është avancimi i kapaciteteve të organizatave lokale qytetare për të ndërtuar iniciativa ndërsektoriale, që synojnë zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve. Projekti synon gjithashtu të forcojë kapacitetet e komuniteteve lokale për të mbledhur fonde përmes iniciativave të udhëhequra nga organizatat qytetare dhe iniciativave publike-private.

Projekti zbatohet në Shkup, Tetovë, Dibër dhe Strumicë. Projekti është i financuar nga bashkimi Evropian. Kohëzgjatja e projektit është në periudhën janar 2021 deri në prill 2024.

Platforma e OJQ-ve, e udhëhequr nga Fondacioni Albiz dhe tre partnerët, kanë konkluduar se sfida kryesore lidhet me mungesën e bashkëpunimit ndërsektorial, e ndjekur nga menaxhimi i pamjaftueshëm i synimit të sektorit privat për të ndihmuar qeverinë në ndërmarrjen e zgjidhjeve të lidhura me komunitetin. Kjo është paraprirë nga OJQ-të apo bazat ende relativisht të dobëta, megjithëse kohët e fundit iniciativat qytetare (shpesh joformale) kanë treguar se duke përdorur qasjen “Mendo globalisht dhe vepro lokalisht” bashkë me mediat digjitale, kanë marrë mbështetje dhe vlerësim nga bizneset lokale nga komunat. Megjithatë, kapaciteti për menaxhimin e projektit, përgjegjshmërinë dhe promovimin e qasjes ndërsektoriale (përfshirë aftësitë për menaxhimin e tij) të OJQ-ve është në nivel të ulët.

Nga ana tjetër, siç tregohet nga anëtarët tanë të asociuar në platformën e OJQ-ve, bizneset janë të fokusuar më së shumti në donacionet dhe marketingun afatshkurtër, në vend të përgjegjësisë sociale të korporatës. Ata kryesisht refuzuan të përfshiheshin në financimin strategjik afatgjatë të ndërhyrjeve të komunitetit, duke ia vendosur përgjegjësinë vetëm sektorit publik (ndërsa besimi i tyre në sektorin qytetar është po aq i ulët). Siç tregojnë provat, qeveritë vendore shpesh janë me para të gatshme kur bëhet fjalë për investimin në sfidat lokale, pasi qeveria qendrore ka ende fuqinë ligjore dhe financiare për të vendosur se cilat komunitete do të financohen. E lartë është edhe mungesa e bashkëpunimit me sektorët tjerë.

Si rezultat i të gjitha këtyre rrethanave, grupet më të cënueshme si të rinjtë dhe gratë janë në barrën e situatës së vështirë, shpesh duke rezultuar në papunësinë ose keqpërdorimin e tyre. Të rinjtë janë aktualisht grupi më i lartë që janë të papunë, ndërsa femrat regjistrojnë pasivitetin më të lartë ekonomik. Nëse mund të gjenden mjete për të ndryshuar këtë dinamikë, komunitetet e Maqedonisë Veriore mund të përfitojnë nga nxitja e ekonomisë lokale. Kjo është arsyeja pse OSHC-të lokale janë të rëndësishme, pasi ato shpesh mbështesin grupet e marginalizuara, por vetë kanë nivel të ulët të ekspertizës në punën me bizneset dhe sektorin publik për të arritur këtë qëllim.

2. RRETH THIRRJES

Thirrja për ri-grantim synon motivimin dhe mbështetjen e organizatave qytetare/bazë për të zbatuar projekte në komunitet që do ta tregojnë rrugën për përmirësimin e mirëqenies së banorëve, me fokus të rinjtë dhe gratë.

Objektivi specifik i thirrjes për mbështetje financiare do të jetë mbështetja e projekteve të përfshira ndërsektoriale të udhëhequra nga OQ në nivel të komunitetit që identifikojnë dhe ndihmojnë në adresimin e sfidave lokale.

Prioritet do t'u jepet OQ që i përfshijnë të rinjtë dhe gratë në vendimmarrje, ose veprimet e tyre ndikojnë në përmirësimin e pozitës së tyre socio-ekonomike në komunitet.

Gjithsej 14 organizata qytetare do të marrin grante, në dy faza: faza e parë do të realizohet në vitin 2022 dhe do të mbështeten 7 iniciativa dhe faza e dytë do të realizohet në vitin 2023 dhe do të mbështeten edhe 7 iniciativa.

Përmes financimit të organizatave qytetare projekti do t'i realizojë rezultatet në vijim:

1. Projekte që do të lënë gjurmë në adresimin e sfidave të komunitetit, veçanërisht ato që përfshijnë grupet e cënueshme;
2. Përpjekje të dokumentuara dhe të aplikuara sektoriale për të adresuar sfidat e komunitetit;
3. Shembuj të përgatitur ose të realizuara të investimeve në komunitet, nëpërmjet përfshirjes së filantropisë korporative/individuale;
4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë sociale për investimet në komunitet tek të gjithë aktorët në nivel lokal;
5. Përfshirja aktive dhe e drejtpërdrejtë e qytetarëve në krijimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore në komunitet, veçanërisht të grave dhe të rinjve;
6. Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial nëpërmjet realizimit të bashkëfinancimit prej 10% nga biznesi, sektori publik apo donatorë të tjerë.

3. E DREJTA PËR APLIKIM

Në këtë thirrje për ri-grantim aplikimet e veta mund t'i parashtrojnë organizatat të cilat janë regjistruar në përputhje me Ligjin për shoqata të qytetarëve dhe fondacione, dhe i plotësojnë kriteret në vijim:

1. Të jenë themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe janë regjistruar si shoqata të qytetarëve së paku 1 vjet para publikimit të kësaj thirrje nga këto qytete: Shkup, Tetovë, Dibër dhe Strumicë;
2. Ta kenë publikuar raportin narrativ dhe financiar për vitin 2021 (opsionale);
3. Të jenë anëtarë të Platformës për investime në komunitet, www.cip.mk, gjegjësisht ta kenë dërguar Fletë anëtarësimin me nënshkrim dhe vulë. Organizatat të cilat tashmë janë anëtarë të platformës nuk ka nevojë ta dërgojnë fletë anëtarësimin;
4. Të jenë aktiv dhe të përgjegjshëm për përgatitjen dhe menaxhimin me projektin;
5. Prioritet kanë organizatat të cilat punojnë me projekte për zgjidhjen e problematikës të rinjve dhe grave.
6. Organizatat që janë bartës ose bashkë-aplikues të Programit IPA për mbështetje të rrjeteve dhe platformave të organizatave të shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut me numër reference: EuropeAid / 167061 / DD / ACT / MK nuk kanë të drejtë si aplikantë në këtë Thirrje.

3.1 AKTIVITETE TË PËRSHTATSHME

Me thirrjen për ri-gantim do të mbështen iniciativat e organizatave qytetare me të cilat do të tregohet rruga drejt përmirësimit të mirëqenies së banorëve, me fokus të rinjve dhe grave (lista nuk është e kufizuar, është e mundur të mbështeten aktivitete të tjera nëse përcaktohet se janë në përputhje me objektivat e projektit):

1. Rrjetëzim efektiv ndërmjet sektorëve të ndryshëm bazuar në zgjidhjen e sfidave (afatgjate) të komunitetit;
2. Hulimtim/analizë që tregon ose harton zgjidhjen e sfidave të komunitetit;
3. Avokim dhe lobim efektiv në sektorin publik dhe privat për investime të përgatitura ose të realizuara në komunitet;
4. Trajnime, seminare dhe fushata për promovimin, ndërgjegjësimin, ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve për grupe të ndryshme shoqërore të qytetarëve, veçanërisht të rinjve dhe grave;
5. Projektet që përmbajnë ndërhyrje specifike ose veprime në terren me ndikim në shoqëri, të cilat janë pjesë e fushës së ekologjisë, mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe kulturës, rekomandohen dhe preferohen shumë.

4. MJETET E DISPONUESHME DHE SHPENZIMET

4.1 MJETET E DISPONUESHME

Vlera e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve të organizatave qytetare me këtë thirrje është 45.500 euro. Hollësitë për buxhetin:

1. Buxhetet e propozim projekteve të dorëzuara për këtë thirrje duhet të jenë minimum 5.000 euro dhe maksimum 6.500 euro;
2. Çdo organizatë duhet të sigurojë minimum 10% (nga buxheti i përgjithshëm i projektit me të cilin aplikohet) ko-financim nga ana e biznesit, sektorit publik ose donatorë të tjerë (qytetarë, diaspora);
3. Koha e zbatimit të propozim-projektit duhet të jetë minimum 9 muaj dhe maksimum 12 muaj;
4. Aktivitetet mund të fillojnë në datën e cekur në kontratën për grant, ndërsa duhet të përfundojnë më së voni më 15 maj 2023.

4.2 SHPENZIMET TË CILAT I MBULON PROJEKTI

Ndarja e shpenzimeve në përqindje është përmendur më poshtë:

1. Burime njerëzore – maksimum 30% nga shpenzimet e përgjithshme të pranuar;
2. Aktivitete programore – shpenzime drejtpërdrejtë të lidhura me zbatimin e projektit – maksimum 60% nga shpenzimet e përgjithshme të pranuar;
3. Aktivitetet për dukshmëri të projektit – maksimum 3% nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme;
4. Shpenzime indirekte – maksimum 7% nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme.

4.3 SHPENZIMET TË CILAT NUK I MBULON PROJEKTI

1. Shpenzime të financuara nga projekt tjetër, gjegjësisht donator për financim të projekteve zbatimi i të cilëve është në vijim e sipër ose të përfunduara;
2. Shpenzime për qëllime individuale si sponsorizime, bursë për studime, trajnime, konferenca etj.;
3. Aktivitete të krijuara për përgatitjen e aplikimit;
4. Humbje gjatë shkëmbimit të valutave; humbje ose taksa të paparapara të aplikuesit, gjegjësisht provizione për humbe ose taksa;
5. Financimi i personave të tretë;
6. Kreditimi i personave të tretë;
7. Blerja e patundshmërisë, mobile, automjete, pajisje, punë ndërtimore, rikonstruim i objekteve ndërtimore;
8. Financimi i aktiviteteve të partive politike;
9. Pagesa e borxheve nga e kaluara;
10. Aktivitete humanitare;
11. Rroga/honorar të punësuarve në administratën publike.

5. MËNYRA E APLIKIMIT

5.1 LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM TË PLOTË:

Organizatrat qytetare është e nevojshme t'i parashtrorjnë aplikimet e tyre përmes formularit për aplikim, i cili i përfshinë pjesët si më poshtë:

1. Shtojca 1: Formulari për aplikim;
2. Shtojca 2: Formulari për buxhet;
3. Kopje e skanuar e faqes së fundit të formularit për aplikim (me vulë dhe nënshkrim);
4. Kopje e gjendjes aktuale, jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e publikimit të thirrjes;
5. Raport narrativ dhe financiar për punën e organizatës për vitin 2021 ose link deri te të njëjtat (opsionale);
6. Biografi pune (CV) e ekipit të projektit;
7. Kopje e raportit të auditit për vitin 20202 (opsionale);
8. Shtojca 3: Listë e referencës të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit (organizatat më të reja se 3 vjet – listë e projekteve të realizuara nga themelimi i saj)
9. Shtojca 4: Deklaratë për financim të dyfishtë
10. Shtojca 5: Lista për kontroll
11. Shtojca 6: Fletë anëtarësim (sipas nevojës)

5.2 PROCEDURA DHE AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM

Afati i fundit për parashtrimin e aplikimeve është 22 prill 2022 deri në ora 16:00.

Aplikimet e parashtruara në këtë Thirrje duhet t'i përmbajnë, të plotësuar në mënyrë të kompjuterizuar dhe të rregullt, dokumentet e listuara.

Aplikimet duhet të jenë të shkruara në gjuhën maqedonase, shqipe ose angleze.

* Kandidatët inkurajohen të parashtrojnë projekt propozime në gjuhën angleze, duke marrë parasysh që zbatimi/komunikimi dhe raportimi i projektit duhet të bëhet në gjuhën angleze.

Aplikimet duhet të parashtrohen në formë elektronike në adresën info@cip.mk.

Titulli i mesazhit me të cilin parashtrohen aplikimet (subject) duhet të jetë: *Aplikim për grant – Platforma për investime në komunitet – faza e parë 2022.*

Dokumentet duhet të dërgohen vetëm në formatet e mbështetura nga Microsoft Office Word и Excel, dhe .PDF ose .JPG nëse fjala është për dokumente të skanuara. Dokumentet nuk duhet të tejkalojnë madhësinë prej 15MB.

Për informacione shtesë të cilat kanë të bëjnë me aplikimet, të interesuarit mund të drejtohen me pyetje në info@cip.mk me shenjë [Info] Thirrje për ri-grantim, më së voni deri më 11 prill 2022, që të mund të merren përgjigjet në kohë, para skadimit të afatit.

Nga ana e Projektit do të organizohen edhe sesione informative për aplikuesit e interesuar, në Shkup, Tetovë, Dibër dhe Strumicë.]

Në tabelën më poshtë mund t'i gjeni detajet për afatet rreth procesit të aplikimit.

Aktiviteti	Data (e planifikuar)	Ora (e planifikuar)
Publikimi i thirrjes	22.03.2022	12:00
Sesion informativ në Shkup	24.03.2022	15:00
Sesion informativ në Tetovë	30.03.2022	15:00
Sesion informativ në Dibër	31.03.2022	14:00
Sesion informativ në Strumicë	01.04.2022	15:00
Sesion informativ on-line	04.04.2022	13:00
Parashtrimi i pyetjeve deri te Fondacioni Albiz	11.04.2022	16:00
Përgjigje nga ana e Fondacionit Albiz	15.04.2022	16:00
Publikimi i rezultateve	10.05.2022	12:00
Nënshkrimi i marrëveshjeve	17.05.2022	13:00
Data fillestare e projekteve	17.05.2022	-

6. VLERËSIMI I PROPOZIM-PROJEKTEVE

6.1 VERIFIKIMI I APLIKIMEVE

Do të merren parasysh vetëm aplikimet e parashtruara në kohë dhe të kompletuara.

Vërejtje: Çdo organizatë mund të parashtrorë vetëm një aplikim, i cili mbetet si evidencë për Projektin, e pakapshme për persona të tretë.

Aplikimet e dorëzuara do t'i nënshtrohen verifikimit administrativ dhe verifikimit të cilësisë së aktiviteteve të propozuara dhe përshtatshmërisë së aplikantëve.

Kriteret për përzgjedhjen e këtyre subjekteve dhe ofrimin e mbështetjes financiare:

1. Kapacitetet organizative për zbatimin e projekt propozimit;
2. Relevanca e propozim projektit me objektivat dhe rezultatet e përcaktuara të Thirrjes;
3. Përshkrimi i projekt propozimit (cilësia e propozimeve);
4. Veprimet e ndërmarra paraprakisht për investime në komunitet;
5. Buxheti dhe efikasiteti i shpenzimeve.

Për aplikim të dorëzuar komplet do të konsiderohet ai që i përfshin të gjithë formularët e plotësuar dhe dokumentet shtesë.

6.2 VLERËSIM PËR CILËSINË DHE PËRSHTATSHMËRINË E APLIKIMIT

Vlerësim për cilësinë dhe përshtatshmërinë e aplikimit	
Kriteret	Pikët
1.Kapacitetet organizative për zbatimin e propozim-projektit	10
1.1. Kapacitetet e organizatës për udhëheqje, administrim dhe menaxhim të projektit	5
1.2. Përvojë paraprake e organizatës nga fusha e temave të cekura	5
2.Relevanca e propozim-projektit me objektivat dhe rezultatet e caktuara të thirrjes	20
2.1. Relevanca e propozim-projektit në përputhje me objektivat dhe pritshmëritë e vendosura në thirrje	10
2.2. Sistem i vendosur i menaxhimit në organizatë	10
3. Përshkrimi i propozim-projektit	40
3.1. Harmonizimi i aktiviteteve të propozuara në propozim-projekt me objektivat e thirrjes	20
3.2. Konkiziteti i planit të veprimit të propozim-projektit	10
3.3. Indikatorë të përcaktuar për arritjen e propozim-projektit	10
4. Veprime paraprakisht të ndërmarra për investime në komunitet	10
4.1. veprime paraprake në fushën e përgjegjësisë shoqërore	10
5. Buxheti dhe efikasiteti i shpenzimeve	20
5.1. Sa korrespondojnë aktivitetet me buxhetin, raporti mes shpenzimeve dhe rezultateve të propozim-projektit	20
Gjithsej pikë:	100

7. INFORMACIONE SHITESË

Për të gjitha organizatat e zgjedhura me këtë thirrje do të organizohet trajnim i detyrueshëm koordinues, në të cilin ekipi i projektit do të japë një shpjegim për rregullat dhe procedurat e projektit.

Çdo organizatë do të ketë një mentor i cili do të japë udhëzime, këshilla dhe do të përfshihet në procesin e përmbushjes së aktiviteteve. Sipas nevojave të çdo organizate do të organizohen trajnime të përshtatshme, me qëllim që organizatat të rrisin kapacitetet e tyre për zhvillim organizativ dhe programor në përputhje me objektivat e projektit.